



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "FAN S. NOLI" KORÇË
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

Nr. 564 Prot.

Korçë më 28.04.2020

VENDIM Nr: 196

PER
SHPALLJEN E PROCESIT TË REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE PËR REKTOR
DHE ANËTAR TË SENATIT AKADEMIK

Në zbatim të Ligjit nr. 80/2015 datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; në Rregulloren "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në UNIKO, miratuar me Vendim të Senatit Akademik nr. 78, datë 4.02.2020"; Kreu IV "Regjistrimi i kandidatëve", neni 18, pika 1,2, neni 6, pika 2, germa/g, Urdhri të MASR nr. 99, datë 26.03.2020, KIZ në mbledhjen e datës 28.04.2020.

V E N D O S I:

- 1- Të shpallë procesin e regjistrimit të kandidatëve për Rektor dhe anëtar senati akademik.
- 2- Regjistrimi i kandidatëve fillon më datë 04.05.2020. ora 08.⁰⁰ dhe përfundon më datë 08.05.2020 ora 16.⁰⁰.
- 3- Kërkesat e kandidatëve të dorëzohen pranë sekretarit të KIZ.
- 4- Ngarkohet Kryetari i KIZ me publikimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Komisioni Institucional Zgjedhor

- ADRIAN MAHO (Kryetar)
- EVJONDA PYLLI (Anëtar)
- SORINA KOTI (Anëtar)
- ILIA DONAÇI (Student)



DOKUMENTACIONI PËR KANDIDIDIM

- a) Kërkesën për kandidim e cila përmban: emrin; atësinë; mbiemrin; datëlindjen; gjininë; shprehjen e vullnetit për kandidim;
- b) Kopje të dokumentit të identifikimit;
- c) Kopje të noterizuar të gradës/titullit akademik;
- d) Dokumentin që vërteton vendin ku kandidati është i punësuar.
- e) Formularët e vetëdeklarimit (të cilët mund të tërhiqen pranë KIZ) për:
 - Deklarimin se kandidati nuk ka fituar dy mandate sipas ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të gjitha mandatet e tjera në vijim të fituara me zgjedhje pavarësisht kohëzgjatjes si autoritet drejtues në postin për të cilin kandidon në Universitetin “Fan S. Noli”;
 - Vetëdeklarim për mungesën e plagjiaturës në punimet për fitimin e gradës shkencore dhe titullit akademik (mungesë plagjiature)
 - Deklarimin që nuk është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale;
 - Deklarimin se nuk ka shkak për të qenë objekt i ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

Dokumentet e kandidimit për studentët anëtarë të Senatit Akademik dorëzohen në KIZ dhe përmbajnë:

- a- Kërkesën për kandidim e cila përfshin, emrin, atësinë, mbiemrin, datëlindjen, gjininë dhe shprehjen e vullnetit për kandidim;
 - b- Kopje të dokumentit të identifikimit;
 - c- Vërtetim që vërteton se është student me kohë të plotë në Universitetin “Fan S. Noli”;
 - d- Propozimi nga jo më pak se 30 studentë pjesë e trupës zgjedhore;
-